

Tiranë, 30/04/2025

TERMAT E REFERENCËS

Emri: Instituti Liberal i Tiranës Pashko
Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", nr. 56, Tiranë
Email: info@ilp-al.org
Afati i dorëzimit: 12/05/2025

ANGAZHIMI I NJË TRAJNERI PËR ZHVILLIMIN E TRAJNIMIT MBI GRAFIK DIZAJN ME TË RINJTË E DY GJIMNAZEVE NË KAMËZ.

SFONDI

Instituti Liberal i Tiranës Pashko, gjatë periudhës shkurt - tetor 2025, po zbaton projektin "DigiRinia-Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re", mbështetur nga Bashkia Kamëz.

Projekti "DigiRinia - Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re" ka si qëllim të krijojë mundësi të qëndrueshme për të rinjtë e Kamzës, duke zhvilluar aftësitë e tyre dixhitale dhe kapacitetet profesionale, përmes krijimit të një Inkubatori Dixhital Rinor. Ky inkubator do të ofrojë mundësi trajnimi dhe mentorimi në fushat kyçe të teknologjisë dhe dixhitalizimit, si menaxhimi i rrjeteve sociale, marketingu dixhital, programimi dhe dizajni grafik. Projekti synon t'i mundësojë të rinjve të konkurojnë në tregun e punës dhe të jenë pjesë aktive e ekonomisë dixhitale, duke kontribuar në uljen e nivelit të papunësisë dhe dëshirës për emigrim, si dhe duke parandaluar keqperdorimin e teknologjisë për qëllime si bullizmi dhe shantazhimi online.

Në këtë kuadër, projekti zhvillohet përmes një qasjeje të përqendruar tek të drejtat e njeriut, ku prioritet mbetet barazia gjinore dhe përfshirja e të rinjve nga komunitetet e marginalizuara ose ata me akses të kufizuar në teknologji. Objektivi kryesor është fuqizimi i këtyre grupeve për t'i ndihmuar ata të arrijnë qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke u mundësuar qasje në mundësi punësimi dhe nisma sipërmarrëse.

QËLLIMI I ANGAZHIMIT

Angazhimi i një trajneri për zhvillimin e trajnimit mbi grafik dizajn në dy gjimnaze në Kamëz.

QËLLIMI I POZICIONIT

Trajneri i kontraktuar do të ketë përgjegjësinë të zhvillojë nga një sesion trajnimi me nxënës të dy gjimnazeve në qytetin e Kamzës me temë grafik dizajn.

Puna e trajnuesit përfshin përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe një prezantimi të shkurtër në PowerPoint. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është pajisja e pjesëmarrësve me aftësi teknike dizajni grafik, duke përdorur aplikacione si Adobe Illustrator dhe Canva, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive krijuese dhe vizuale të të rinjve për përdorim në projekte dixhitale.

DORËZIMI I SHËRBIMIT

1 trajner do të punojë për 3 ditë pune. Respektivisht 1 ditë punë do ti shërbejë për përgatitje për trajnim, si dhe 2 ditë të tjera pune për zhvillimin e trajnimeve në dy gjimnazet në Kamëz, target të projektit.



DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Trajneri duhet të zhvillojë në mënyrë profesionale dhe lehtësisht të kuptueshme sesionin e trajnimit me nxënësit e dy gjimnazeve në Kamëz target të projektit mbi temën e lidhur me grafik dizajn;
- Trajneri duhet të dorëzojë materialet e trajnimit dhe një prezantim të shkurtër në PowerPoint sipas temës së trajtuar në trajnim;
- Të dorëzojë shërbimin brenda afatit të përcaktuar nga organizata kontraktuese;
- Të koordinojë punën në bashkëpunim dhe komunikim të ngushtë me stafin e projektit;
- Pas përfundimit të trajnimeve, çdo trajner duhet të dorëzojë raportin narrativ mbi realizimin e trajnimit pranë stafit të projektit;

KUALIFIKIME DHE EKSPERIENCË

- Të ketë diplomë universitare në Shkenca Kompjuterike, IT, Grafik Dizajn ose një fushë tjetër të ngjashme dhe të lidhur me tematikën e projektit;
- Të ketë të paktën 2 vite eksperiencë në trajnime dhe programe fuqizuese;
- Të kenë aftësi organizative dhe komunikimi;
- Të kenë njohuri të shkëlqyera të gjuhës shqipe; preferohet njohja e gjuhës angleze;

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

- CV e aplikantit;
- Dorëzimi i materialeve të trajnimit, moduleve dhe prezantimit të shkurtër në PowerPoint;
- Kontrata/prova të eksperiencës së ngjashme në trajnime profesionale (opsionale);
- Oferta financiare nga trajneri, me një shumë maksimale prej 90,000 lekë.

Aplikimi duhet të dërgohet me email në adresën: info@ilp-al.org brenda datës: 12/05/2025.



UDHËZIME PËR OFERTUESIT

Kur paraqesin ofertat e tyre, ofertuesit duhet të ndjekin të gjitha udhëzimet, format, termat e referencës, dispozitat kontraktuale dhe specifikimet e përfshira në këtë dosje prokurimi. Mosdorëzimi i një oferte që përmban të gjitha informacionet dhe dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar mund të çojë në refuzimin e saj.

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e kontratave të financuara në kuadër të kësaj thirrjeje për prokurim.

FURNIZIMI/SHËRBIMI I KËRKUAR

Furnizimet e kërkuara janë përshkruar në Termat e Referencës.

AFATET KOHORE

Afati për kërkesë për sqarime: **06.05.2025, ora 23:59**

Afati për dorëzimin e ofertave: **12.05.2025, ora 23:59**

(Të gjitha oraret janë përcaktuar sipas orës lokale të autoritetit kontraktues)

PJESËMARRJA DHE NËNKONTRAKTIMI

- Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë.
- Nëse përdoret nënkontraktor, duhet të jepet emri, vlera dhe përqindja përkatëse në ofertën financiare.

PËRMBAJTJA E OFERTËS

Dokumentet duhet të jenë në **shqip**.

Oferta duhet të përmbajë:

- **Ofertën teknike** (CV ose link i faqes së ofertuesit)
- **Ofertën financiare** në lekë, sipas formatit të dhënë

Buxheti maksimal: 90,000 ALL

PYETJE PARA AFATIT TË DORËZIMIT

- Pyetjet mund të dërgohen me email në: info@ilp-al.org deri më **06.05.2025**.
- Nuk do të zhvillohet takim apo vizitë në zyrë.

DORËZIMI I OFERTAVE

Vetëm nëpërmjet emailit në: info@ilp-al.org deri më **12.05.2025, ora 23:59**.

SHPENZIMET E OFERTUESIT

Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nuk rimbursohen.

VLERËSIMI I OFERTAVE

- Nuk parashikohet intervistë.
- Ofertat mbi buxhetin maksimal do të refuzohen.
- Përzgjedhja bëhet mbi parimin **çmim-cilësi**.

ETIKA DHE PRAKTIKAT E NDALUARA

- Çdo përpjekje për ndikim të padrejtë në procedurë do të çojë në përjashtim.
- Ndalohet konflikti i interesit dhe shpenzimet e pazakonta komerciale.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS

- Ofertuesi fitues njoftohet dhe duhet të nënshkruajë kontratën brenda **30 ditëve**.

ANULIMI I PROCEDURËS

Autoriteti kontraktues mund të anulojë procedurën në raste të veçanta, si: mungesë ofertash të vlefshme, ndryshime të rëndësishme, forca madhore, tejkalim buxheti ose shkelje në proces.

FORMULARI I DORËZIMIT TË SHËRBIMIT

Aktiviteti 2.1: Organizimi i 10 trajnimeve për zhvillimin e aftësive dixhitale për të rinjtë.

Projekti: “DigiRinia-Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re”

Emri i Ekspertit:

Shuma totale e ofertës:

Nr.	Shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Shërbim ekspertize për Grafik Dizajn	Fee	1		

Nënshkruar në emër të Ekspertit

Emri & Mbiemri:

Firma:

